

UDHËZIME PËR PËRDORIMIN E FORMËS SË VET DEKLARIMIT PËR BANIM PARËSOR

1. Forma shërben për vetdëklarimin e venbanimit parësor nga ana e tatimpaguesve
2. Forma i jepet tatimpaguesit vetëm nëse ai/ajo posedon numër personal i cili dokument fotokopjohet dhe ruhet në regjistrin e tatimit në pronë.
3. Forma duhet të plotësohet nga tatimpaguesi dhe me asistimin e zyrtarit komunal në rolin e sqaruesit dhe lehtësuesit që forma të jetë e pa gabime dhe e kuptueshme
4. Forma përdoret për vetdëklarimin e banimit parësor brenda një komune ose në komuna tjera.
5. Nëse tatimpaguesi paraqitet në Komunën e Fushë Kosovës dhe dëshiron ndërrimin e venbanimit parësor nga komuna e Fushë Kosovës në Komunën e Prishtinës, procedura është si në vazhdim:
 - Hapi parë: Verbalisht nga tatimpaguesi kërkohet të deklarohej në lidhje me kërkesën e tij/saj
 - Hapi dytë: Njoftohet tatimpaguesi me njësit e objekteve që ai/ajo posedon dhe në cilin nga objektet rezidenciale e ka venbanimin parësor.
 - Hapi tretë: Nëse tatimpaguesi kërkon ndërrimin e venbanimit parësor atëherë i jepet forma për plotësim dhe udhëzohet/asistohet për plotësimin e formës.
 - Hapi katërt: Me telefon kontaktohet zyrtari kontaktues i komunës së Prishtinës dhe verbalisht njoftohet me të dhënat e tatimpaguesit dhe kërkesën e tij/saj.
 - Hapi i pestë: Forma origjinale e tatimpaguesit e nënshkruar skanohet dhe shtypet. Forma origjinale ruhet si kopje fizike në regjistrin fizik të tatimpaguesve, ndërsa forma e skanuar në imellën zyrtare i dërgohet zyrtarit/es së komunës së Prishtinës, si dhe forma e shtypur i jepet tatimpaguesit.
 - Hapi gjashtë: Në sistemin e IT së tatimit në pronë zyrtari i Komunës së Fushë Kosovës ndërron statusin e atributit të venbanimit parësor nga Po në Jo dhe i ruan ndryshimet dhe bënë rillogaritje të re.
 - Hapi shtatë: Kontaktohet zyrtari kontaktues i komunës së Prishtinës dhe i kërkohet që në pajtim me formën e vetdëklaruar për venbanimin parësor komuna e Prishtinës në njësin e objektit rezidencial të ndryshohet statusi i atributit të venbanimit parësor nga Jo në Po. Zyrtari/ja e Komunës së Prishtinës krijon regjistrin Fizik dhe elektronik të menagjimit të kërkeësve për ndërrimet në venbanimin parësor.
 - Hapi tetë: Komuna e Prishtinës bënë rillogaritjen e re dhe në kthim të imellit njofton zyrtarin e komunës së Fushë Kosovës për kryerjen e veprimeve të kërkuara.
 - Hapi nëntë: Zyrtari i Komunës së Fushë Kosovës shtyp faturën e re dhe dokumentet tjera përcjellëse dhe i dorëzon tatimpaguesit.
6. Të gjitha veprimet e lartëshënuara duhet të kryhen në të njëjtën ditë që tatimpaguesi kërkon shërbimin me përjashtim nëse ka kufizime ligjore për ndonjë nga veprimet e kërkuara dhe për këtë informohet tatimpaguesi.
7. Ministria e Financave-Departamenti i Tatimit në Pronë do të ju dërgon listën e kontakteve të të menaxherëve ose zyrtarëve përgjegjës të të gjitha komunave.
8. Për qdo sqarim apo situatë të re që nuk janë dhënë instruksione në këtë udhëzim të kontaktohet tavolina ndihmëse.

Prishtinë, 08.04.2019